



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



BULETINI I PRONËSISË INDUSTRIALE (Patenta)

Nr. 14/2023
Tiranë më, 26 Prill 2023

Kodet e përdorura në gazette.....	3
INID Codes used in gazette	
Kodet e shteteve.....	4
States codes	
Patenta të lëshuara.....	9
Granted Patents	
Transferim i pronësisë	16
Change of Ownership	
Ndryshimi i emrit të pronarit/aplikantit.....	19
Change of name.	
Aplikime kombëtare për patente.....	21
National Applications	

Kodet INID dhe minimumi i kërkuar për identifikimin e të dhënave bibliografike lidhur me:

Patentat.

- (11) Numri i patentës
- (21) Numri kombëtar i aplikimit
- (22) Data e depozitimit në Shqipëri
- (30) Prioriteti
- (54) Titulli i shpikjes
- (57) Pretendimet
- (71) Emri dhe adresa e aplikuesit
- (72) Emri/ Adresa e Shpikësit
- (73) Emri dhe adresa dhe pronarit të patentës
- (92) Numri dhe data e autorizimit të hedhjes së produktit në treg
- (95) Produkti i identifikuar në autorizimin e hedhjes së tij në treg
- (96) Numri dhe data ndërkombëtare e aplikimit
- (97) Numri dhe data Nderkombëtare e publikimit

Kodet e shteteve

Afghanistan / Afganistani	AF
Albania / Shqipëria	AL
Algeria / Algjeria	DZ
Angola / Anguila	AI
Antigua and Barbuda / Antigua dhe Barbud	AG
Argentina / Argjentina	AR
Aruba / Aruba	AW
Australia / Australia	AU
Austria / Austria	AT
Bahamas / Bahamas	BS
Bahrain / Bahrein	BH
Bangladesh / Bangladeshi	BD
Barbados / Barbados	BB
Belarus / Bjellorusia	BY
Belgium / Belgjika	BE
Belize / Belice	BZ
Benin / Benin	BJ
Bermuda / Bermuda	BM
Bhutan / Bhutan	BT
Bolivia / Bolivia	BO
Bosnia Herzegovina / Bosnja Hercegovina	BA
Botswana / Botsvana	BW
Bouvet Islands / Ishujt Buver	BV
Brazil / Brazili	BR
Brunei Darussalam/Brunei Darusalem	BN
Bulgaria / Bullgaria	BG
Burkina Faso / Burkina Faso	BF
Burma / Burma	MM
Burundi / Burundi	BI
Cambodia / Kamboxhia	KH
Cameroon / Kameruni	CM
Canada / Kanada	CA
Cape Verde / Kepi i Gjëlber	CV
Cayman Islands / Ishujt Kaiman	KY
Central African Republic / Republika e Afrikës Qendrore	CF
Chad/ Cadi	TD
Chile / Kili	CL
China / Kina	CN
Colombia / Kolumbia	CO
Comoros / Komoros	KM
Congo / Kongo	CG
Cook Islands / Ishujt Kuk	
Costa Rica / Kosta Rika	CR
Cote d'Ivoire / Bregu I Fildishte	CI
Croatia / Kroacia	HR
Cuba / Kuba	CU
Cyprus / Qipro	CY
Czech Republic / Republika Çeke	CZ

Denmark / Danimarka	DK
Djibouti / Xhibuti	DJ
Dominika / Domenika	DM
Dominican Republic / Republika Domenikane	DO
Ecuador / Ekuadori	EC
Egypt / Egjipti	EG
El Salvador / El Salvadori	SV
Equatorial Guinea / Guinea Ekuatoriale	GQ
Erintrea / Erintrea	ER
Estonia / Estonia	EE
Ethiopia / Etiopia	ET
Falkland Islans / Ishujt Malvine	FK
Fiji / Fixhi	FJ
Findland / Findland	FI
France / Franca	FR
Gabon / Gaboni	GA
Gambia / Gambia	GM
Georgia / Gjeorgjia	GE
Germany / Gjermania	DE
Ghana / Gana	GH
Gibllartar / Gjibraltari	GI
Greece / Greqia	GR
Grenada / Granada	GD
Guatemala / Guatemala	GT
Guinea / Guinea	GN
Guinea Bissau / Guinea Bisao	GW
Guyana / Guajana	GY
Haiti / Haiti	HT
Honduras / Hondurasi	HN
Hong Kong / Hong Kongu	HK
Hungary / Hungaria	HU
Iceland / Islanda	IS
India / India	IN
Indonezia / Indonezia	ID
Iran / Irani	IR
Iraq / Iraku	IQ
Ireland / Irlanda	IE
Israel / Israeli	IL
Italy / Italia	IT
Jamaica / Xhamaika	JM
Japan / Japonia	JP
Jordan / Jordania	JO
Kazakhstan / Kazakistani	KZ
Kenya / Kenia	KE
Kiribati / Kiribati	KI
Korea / Korea	KR
Kyrgyzstan / Kirgistan	KG
Kwait / Kuvaiti	KW
Laos / Laosi	LA
Latvia / Letonia	LV
Lebanon / Libani	LB

Lesotho / Lesoto	LS
Liberia / Liberia	LR
Macau / Makau	MO
Madagascar / Madagaskari	MG
Malawi / Malavi	MW
Malaysia / Malaizia	MY
Maldives / Maldives	MV
Mali / Mali	ML
Malta / Malta	MT
Marshall Islands / Ishujt Marshall	MH
Mauritania / Mauritania	MR
Mauritius / Mauritius	MU
Mexico / Meksika	MX
Monaco / Monako	MC
Mongalia / Mongolia	MN
Montserrat / Montserrati	MS
Morocco / Maroku	MA
Mozambique / Mozambiku	MZ
Myanmar / Myanmar	MM
Namibia / Namibia	NA
Nauru / Nauru	NR
Nepal / Nepal	NP
Netherlands / Hollanda	NL
Netherlands Andilles /Antilet Hollandeze	AN
New Zealand / Zelanda e Re	NZ
Nicaragua / Nikaragua	NI
Niger / Nigeri	NE
Nigeria / Nigeria	NG
Norway / Norvegjia	NO
Oman / Omani	OM
Pakistan / Pakistani	PK
Palau / Palau	PW
Panama / Panamaja	PA
Papua New Guinea / Papua Guinea e Re	PG
Paraguay / Paraguai	PY
Peru / Peruja	PE
Philippines / Filipine	PH
Poland / Polonia	PL
Portugal / Portugalia	PT
Qatar / Katari	QA
Republik Of Moldova / Republika e Moldavise	MD
Romania / Rumania	RO
Russian Federation/Federata Ruse	RU
Rwanda / Ruanda	RW
Saint Helena / Shen Helena	SH
Saint Kitts and Nevis / Shen Kits dhe Nevis	KN
Saint Lucia / Shen Lucia	LC
Saint Vincent and the Grenadines / Shen Vinsenti dhe Grenadinet	VC
Samoa / Samoa	WS
San Marino / San Marino	SM
Sao Tome and Principe /Sao Tome dhe Principe	ST

Saudi Arabia / Arabia Saudite	SA
Senagal / Senegali	SN
Seychelles / Sejshellet	SC
Sierra Leone / Sierra Leone	SL
Singapore / Singapori	SG
Slovakia / Sllovakia	SK
Slovenia / Sllovenia	SI
Solomon Islans / Ishujt Solomone	SB
Somalia / Somalia	SO
South Africa / Afrika e Jugut	ZA
Spain / Spanja	ES
Sri Lanka / Sri Lanka	LK
Sudan / Sudani	SD
Suriname / Surinami	SR
Swaziland / Shvacilandi	SZ
Sweden / Suedia	SE
Switzerland / Zvicra	CH
Syria / Siria	SY
Taiwan / Taivani	TW
Thailand / Tailanda	TH
Togo / Togo	TG
Tonga / Tonga	TO
Trinidad and Tobago / Trinidad dhe Tobako	TT
Tinisia / Tunizia	TN
Turkey / Turqia	TR
Turkmenistan / Turkmenistani	TM
Turks and Caicis Islands / Ishujt Turk dhe Kaiko	TC
Tuvalu / Tuvalu	TV
Uganda / Uganda	UG
Ukraine / Ukraina	UA
United Arab Emirates /Emiratet e Bashkuara Arabe	AE
United Kingdom/ Mbreteria e Bashkuar	GB
United Republic of Tanzania / Republika e Bashkuar e Tanzanise	TZ
United States of America / Shtetet e Bashkuara te Amerikes	US
Uruguay / Uruguai	UY
Uzbekistan / Uzbekistani	UZ
Vanuatu / Vanuatu	VU
Vatican / Vatikani	VA
Venezuela / Venezuela	VE
Vietnam / Vietnami	VN
Virgin Islands / Ishujt Virxhin	VG
Yemen / Jemeni	YE
Yugoslavia / Jugosllavia	YU
Zaire / Zaireja	ZR
Zambia / Zambia	ZM
Zimbabwe / Zimbabve	ZW

PATENTA TË LËSHUARA

(11) **11333**

(97) EP3498111 / 06/07/2022

(96) 17207023.7 / 13/12/2017

(22) 30/09/2022

(21) AL/P/ 2022/486

(54) **SHIRIT I GARNITURËS**

19/04/2023

(30)

(71) Max Schlatterer GmbH & Co. KG

Robert-Bosch-Str. 9, 89542 Herbrechtingen, DE

(72) Renner, Stefan (Untere Str. 1, 89584 Ehingen); Bez, Frank (Helmut-Ginzkey-Weg 5, 73566 Bartholomä); Wagner, Andreas (Heidenheimer Str. 4, 89564 Nattheim)

(74) Aleksandra ARSENI

Rr.Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, Shk.5,Ap70/4 Tiranë, 100

(57)

1. Shirit garniture (1) për prodhimin e cigareve ose filtrave për cigare, që kanë një faqe (1a) e cila qëndron përballë produktit që do të prodhohet dhe që ka një faqe (1b) e cila qëndron përballë larg nga produkti që do të prodhohet, karakterizuar në atë që të paktën një element udhëzues (2) për drejtimin e shiritit të garniturës (1) në një garniturë (3) është vendosur mbi faqen (1b) e cila qëndron përballë larg nga produkti që do të prodhohet.

2. Shirit garniture sipas Pretendimit 1, karakterizuar në atë që elementi udhëzues (2) shkon përgjatë të paktën përafërsisht të gjithë gjatësisë së shiritit të garniturës (1).

3. Shirit garniture sipas Pretendimit 1, karakterizuar në atë që janë ofruar elementet udhëzuese individuale (2) të cilat janë vendosur veçmas nga njëra-tjetra.

4. Shirit garniture sipas Pretendimit 3, karakterizuar në atë që të paktën disa prej elementeve udhëzuese (2) janë me konfigurim që ngjan si dhëmb.

5. Shirit garniture sipas çdonjërit prej Pretendimeve 1 deri 4, karakterizuar në atë që paktën një element udhëzues (2) është konfiguruar në formën e një zgjatjeje (2a).

6. Shirit garniture sipas Pretendimit 5, karakterizuar në atë që lartësia (h) e të paktën një elementi udhëzues (2) pingul me një rrafsh në të cilin shiriti i garniturës (1) shtrihet është 1 deri 7 mm, preferueshëm 1 deri 5 mm, veçanërisht preferueshëm 1 deri 3 mm.

7. Shirit garniture sipas çdonjërit prej Pretendimeve 1 deri 4, karakterizuar në atë që të paktën një element udhëzues (2) është konfiguruar në formën e një dhëmbëzimi (2b).

8. Shirit garniture sipas çdonjërit prej Pretendimeve 1 deri 7, karakterizuar në atë që gjerësia (b) e të paktën një elementi udhëzues (2) në një drejtim tërthor (y) të shiritit të garniturës (1) është 1 deri 20 mm, preferueshëm 1 deri 10 mm.

9. Shirit garniture sipas çdonjërit prej Pretendimeve 1 deri 8, karakterizuar në atë që të paktën një element udhëzues (2) është lidhur me shiritin e garniturës (1) nëpërmjet mjeteve të derdhjes, ngjitjes me adeziv, qepjes dhe/ose shkrirjes.

10. Shirit garniture sipas çdonjërit prej Pretendimeve 1 deri 8, karakterizuar në atë që shiriti i garniturës (1) përmban një pëlhurë të endur që ka fije të prishura dhe fije të mbushura, në të cilën të paktën një element udhëzues (2) është formuar nëpërmjet mjeteve të fijeve të prishura shtesë.

11. Garniturë (3) për prodhimin e cigareve ose filtrave për cigare, që kanë një ndërprerje për të marrë një shirit garniture (1), në të cilin ndërprerja përmban të paktën një ndërprerje (4) që shkon në drejtim dalës (x) të shiritit të garniturës (1) dhe që është menduar të marrë element udhëzues (2) të shiritit të garniturës (1), në të cilin ndërprerja (4) ka një formë T në seksionin e kryqëzuar, dhe ka një shirit garniture (1) sipas çdonjërit prej Pretendimeve 1 deri 10 i cili është drejtuar në ndërprerje (4), ku elementi udhëzues (2) i shiritit të garniturës (1) ka një formë T në seksionin e kryqëzuar.

12. Metodë për prodhimin e një shiriti garniture (1) për prodhimin e cigareve ose filtrave për cigare, në të cilën shiriti i garniturës (1) ka një faqe (1a) që qëndron përballë produktit që do të prodhohet dhe ka një faqe (1b) që qëndron përballë larg nga produkti që do të prodhohet është prodhuar, karakterizuar në atë që të paktën një element udhëzues (2) për drejtimin e shiritit të garniturës (1) në një garniturë (3) është gjeneruar në faqen (1b) e shiritit të garniturës (1) që qëndron përballë larg produktit që do të prodhohet.

13. Metodë sipas Pretendimit 12, karakterizuar në atë që të paktën një element udhëzues (2) është lidhur me shiritin e garniturës (1) nëpërmjet derdhjes.

(11) **11334**

(97) EP3656393 / 24/08/2022

(96) 19215699.0 / 25/04/2012

(22) 03/11/2022

(21) AL/P/ 2022/530

(54) **PËRGATITJA E LIOFILIZUAR E DIPEPTIDEVE CITOTOKSIKE**

20/04/2023

(30) 1150371 28/04/2011 SE and 201161535126 P 15/09/2011 US

(71) Oncopeptides AB

Västra Trädgårdsgatan 15, 111 53 Stockholm, SE

(72) SPIRA, Jack (Näsbyvägen 38, 135 53 Tyresö) ;LEHMANN, Fredrik (Kanalvägen 61, 191 34 Sollentuna)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. "Ibrahim Rugova", P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar që përfshin

(i) flufenamid melfalan, ose një kripë të tij farmaceutikisht të pranueshme; dhe

(ii) saharozë.

2. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar sipas pretendimit 1, ku sasia e ekscipientit është 10-100 % nga pesha e flufenamidit melfalan në fjalë.

3. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar sipas pretendimit 1 ose 2, që përfshin më tej një tretësirë fiziologjikisht të pranueshme.

4. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-3, i cila është e lirë, ose në mënyrë thelbësore e lirë nga tretësit organikë.

5. Një komplet pjesësh që përfshin

(i) një përgatitje farmaceutike të liofilizuar sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-4; dhe

(ii) një tretësirë fiziologjikisht të pranueshme.

6. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-4, për përdorim si një medikament.

7. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-4, për përdorim në trajtimin dhe/ose parandalimin e kancerit.

8. Një përgatitje farmaceutike e liofilizuar sipas pretendimit 7, ku kanceri në fjalë është çdonjëri nga kanceri i vezoreve, kanceri i mushkërive, kanceri i fshikëzës urinare, mesotelioma, mieloma e shumëfishtë, kanceri i gjirit ose kanceri hematologjik.

9. Një komplet pjesësh sipas pretendimit 5, për përdorim në trajtimin e kancerit, për shembull ku kanceri në fjalë është çdonjëri nga kanceri i vezoreve, kanceri i mushkërive, kanceri i fshikëzës urinare, mesotelioma, mieloma e shumëfishtë, kanceri i gjirit ose kanceri hematologjik.

10. Një metodë për përgatitjen e një përgatëse farmaceutike të liofilizuar sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-4, ku:

- a. flufenamid melfalan, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme, është tretur në një tretës organik për të përftuar një tretësirë flufenamid melfalani;
- b. uji është shtuar te tretësira e flufenamid melfalanit në mënyrë që të përftohet një tretësirë flufenamid melfalani ujore, në një përqendrim 0.2-3.0 mg/ml;
- c. saharoza është shtuar tretësirës së flufenamid melfalanit; dhe
- d. tretësira ujore e flufenamid melfalanit që përmban ekscipient(ët) i nënshtrohet liofilizimit.

11. Metoda sipas pretendimit 10, ku:

- a. flufenamid melfalani, ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme, është e tretur në një tretës organik;
- b. uji është shtuar tretësirës së përftuar në hapin a) në mënyrë që të përftohet një tretësirë e flufenamid melfalanit në fjalë ose një kripë e tij farmaceutikisht e pranueshme, në një përqendrim prej 0.2-3.0 mg/ml;
- c. saharoza është shtuar tretësirës së përftuar në hapin b; dhe
- d. tretësira e përftuar në hapin c) i nënshtrohet liofilizimit.

12. Një metodë sipas pretendimit 10 ose 11, ku tretësi organik është zgjidhur nga çdonjëri prej etanolit, etanolit që përmban acid, glicerinës, propilen glikolit, benzil alkoolit, dimetilacetamidit (DMA), N-metil-2-pirrolidonit, izopropanolit, n-butanolit, tert-butanolit, metil tert-butil eterit, propilen glikolit, dimetilsulfoksidit, tetrahidrofuranit, 2-metil tetrahidrofuranit, acetoni, dimetilformamidit, acetonitrilit, dioksanit, acidit acetik, acidit laktik, acidit propionik, n-butanolit, izopropanolit, n-propanolit, tert-butanolit, sec-butanolit, metanolit dhe një përzierje të etanolit dhe ujit.

(11) **11336**

(97) EP3930663 / 07/09/2022

(96) 20711798.7 / 27/02/2020

(22) 15/11/2022

(21) AL/P/ 2022/547

(54) **PRODUKT I KUJDESIT ORAL**

25/04/2023

(30) 201900003009 01/03/2019 IT

(71) CURASEPT A.D.S. S.P.A.

Via Parini 19/A, 21047 Saronno, IT

(72) BOIOCCHI, Lorenzo Emiliano (Via Giacinto Bruzzesi, 27, 20146 Milano)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. ADN natriumi për përdorim në një metodë për trajtimin e efekteve anësore të klorheksidinës në një pacient që i nënshtrohet trajtimit me klorheksidinë, ku efekte anësore të tilla sjellin një ndryshim të

strukturës qelizore të mukozës orale të pacientit të sipërpërmendur, ndryshimet e sipërpërmendura të strukturës qelizore që janë të zgedhura nga grupi i përbërë prej: vakuolizimi, degjenerimi i bërthamës qelizore, zgjerimi i hapësirave ndërqelizore.

2. ADN natriumi për përdorim sipas pretendimit 1, në të cilin trajtimi me klorheksidinë i sipërpërmendur është bërë me një produkt të kujdesit oral që përfshin klorheksidinë dhe ADN natriumi.

3. ADN natriumi për përdorim sipas pretendimit 2, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur që përfshin klorheksidinë dhe ADN natriumi është zgjedhur nga grupi i përbërë prej: larës goje, xhel periodontal, dhe pastë dhëmbësh.

4. ADN natriumi për përdorim sipas pretendimit 3, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje dhe sasia e klorheksidinës është në intervalin nga 0.01% deri në 0.30% nga pesha krahasuar me vëllimin total të larësit të gojës.

5. ADN natriumi për përdorim sipas 3 ose 4, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje dhe klorheksidinë është në formën e një kripe ose një kompleksi.

6. ADN natriumi për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 3 deri në 5, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje dhe sasia e ADN natriumit është në intervalin nga 0.01% deri në 0.2% nga pesha krahasuar me vëllimin total të larësit të gojës.

7. ADN natriumi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 6, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje që përfshin të paktën një kripë metabisulfit të një metali alkaline ose alkaline tokësor.

8. ADN natriumi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 7, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje që përfshin acid askorbik.

9. ADN natriumi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 8, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje që përfshin të paktën një kopolimer polivinilpirrolidon-vinilacetat.

10. ADN natriumi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 9, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje që përfshin citrat tribazik të natriumit.

11. ADN natriumi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 3 deri në 10, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një larës goje që përfshin nga 0.01% deri në 0.30% nga pesha e klorheksidinës, nga 0.01% deri në 0.2% nga pesha e ADN natriumit, nga 0.1% deri në 0.5% nga pesha e të paktën një kripe metabisulfit të një metali alkaline ose alkaline tokësor, nga 0.1% deri në 1.0% nga pesha e acidit askorbik, nga 0.05% deri në 1% nga pesha e të paktën një kopolimeri polivinil pirrolidon-vinil acetat, krahasuar me vëllimin total të larësit të gojës.

12. ADN natriumi për përdorim sipas pretendimit 3, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një xhel periodontal që përfshin nga 0.5% deri në 1.0% nga pesha e klorheksidinës, krahasuar me vëllimin total të xhelit periodontal.

13. ADN natriumi për përdorim sipas 3 ose 12, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një xhel periodontal që përfshin ADN natriumi në një sasi më së shumti prej 0.3% nga pesha krahasuar me peshën totale të xhelit periodontal.

14. ADN natriumi për përdorim sipas pretendimit 3, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një pastë dhëmbësh që përfshin nga 0.05% deri në 0.2% nga pesha e klorheksidinës, krahasuar me vëllimin total të pastës së dhëmbëve.

15. ADN natriumi për përdorim sipas pretendimit 3 ose 14, ku produkti i kujdesit oral i sipërpërmendur është një pastë dhëmbësh që përfshin ADN natriumi në një sasi nga 0.01% deri në 0.05% nga pesha krahasuar me vëllimin total të pastës së dhëmbëve.

16. ADN natriumi për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 15, ku trajtimi me klorheksidinë i sipërpërmendur është për trajtimin e të paktën një patologjie të zgjedhur në grupin e përbërë prej: gingivitit, pllakave bakteriale, dhe periodontitit.

(11) **11335**

(97) EP3783110 / 23/11/2022

(96) 20200970.0 / 05/11/2010

(22) 05/12/2022

(21) AL/P/ 2022/580

(54) **ANALIZË GENOMIKE FETALE NGA NJE MOSTËR BIOLOGJIKE MATERNALE**

20/04/2023

(30) 25856709 P 05/11/2009 US; 25907509 P 06/11/2009 US and 38185410 P 10/09/2010 US

(71) Sequenom, Inc. and The Chinese University Of Hong Kong

3595 John Hopkins Court, San Diego, CA 92121, US ;Office of Research and Knowledge Transfer Services Room 301 Pi Ch'iu Building Shatin, New Territories, Hong Kong, CN

(72) LO, Yuk Ming Dennis (4th Floor 7 King Tak Street, Homantin, Kowloon, Hong Kong); CHAN,

Kwan Chee (Flat A 13/F Block 34 Broadway Street Mei Foo Sun Chuen, Kowloon, Hong Kong); CHIU,

Wai Kwun Rossa (House 31 Double Haven 52 Ma Lok Path, Shatin New Territories, Hong Kong)

;CANTOR, Charles (526 Stratford Court, Del Mar, California 92014)

(74) Arben Kryeziu

Rr. Idriz DOLLAKU, Pall.5, Shk.2, Ap.39, Tirane, Albania, AL, Rr. Idriz DOLLAKU, Pall.5, Shk.2, Ap.39, Tirane, Albania, AL

(57)

1. Metodë për përcaktimin e një përqëndrimi (koncentrimi) të DNA fetale në një mostër të marrë nga një femër shtatzënë me një fetus, fetus, i cili ka një baba dhe një nënë e cila është një femër shtatzënë, ku nëna ka një genom maternal, fetusin ka një genom fetal, ku mostra biologjike përmban një përzjerje të acideve nukleike fetale dhe maternale, metodë e cila përfshin:

analizimin e një shumice molekulash të acidit nukleik nga mostra biologjike, ku analizimi i molekulës së acidit nukleik përfshin:

identifikimin e vendosjes të molekulës së acidit nukleik tek genomi human; dhe përcaktimin e alleleve respektive të molekulës së acidit nukleik;

përcaktimin e një ose më shumë vendndodhjeve të para ku genomi fetal është heterozig në çdo vendndodhje të parë në mënyrë të tillë që genomi fetal ka një allele të parë dhe të dytë respektive në atë vendndodhje, dhe ku genomi maternal është homozig në secilën vendndodhje të parë në mënyrë të tillë që genomi maternal ka dy nga allelet e dyta respektive në vendndodhjen e parë, ku allele e parë është e ndryshme nga allele e dytë, ku përcaktimi i një vendndodhjeje specifike të jetë një nga ato një ose më shumë vendndodhjet e para përbëhet nga :

përcaktimi i një vlere të shkurtuar për një numër llogaritjesh të parashikuara të alleles së parë respektive në një vendndodhje specifike, ku vlera e shkurtuar të parashikojë nëse vlera është përcaktuar bazuar në një shpërndarje statistikore të numrave të llogaritjeve për kombinime të ndryshme homozige dhe heterozige në vendndodhjen specifike;
bazuar në analizën e shumicës së molekulave të acidit nukleik duke zbuluar allelen e parë respektive dhe allelen e dytë respektive të vendndodhjes specifike;
përcaktimi i një numri llogaritjesh aktuale të alleles së parë respektive bazuar në analizën e shumicës së molekulave të acidit nukleik nga mostra biologjike; dhe
përcaktimi i vendndodhjes specifike është një nga vendndodhjet e para kur numri i llogaritjeve aktuale është më i vogël se vlera e shkurtuar;

për të paktën një nga vendndodhjet e para:

përcaktimi i një numri të parë P llogaritjesh të alleles së parë respektive dhe një numri të dytë Q llogaritjesh të alleles së dytë respektive; dhe
kalkulimi i koncentrimin fraksional bazuar në numrat e parë dhe të dytë.

2. Metoda e pretendimit 1, ku koncentrimi fraksional përcaktohet si $2xp/(p+q)$.
3. Metoda e pretendimit 1 ose 2 ku P dhe Q përcaktohen për një shumicë të vendndodhjeve të para, dhe

$$f = \frac{\sum_{i=1}^n 2p_i}{\sum_{i=1}^n (p_i + q_i)}$$

ku koncentrimi fraksional f përcaktohet si $f = \frac{\sum_{i=1}^n 2p_i}{\sum_{i=1}^n (p_i + q_i)}$, ku p_i është numri i parë për vendndodhjet e para i th dhe q_i është numri i dytë për vendndodhjet e para i th.

4. Metoda e çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku përcaktimi i vlerës së shkurtuar përfshin përcaktimin e shpërndarjes statistikore për një koncentrim fraksional maksimal dhe minimal.
5. Metoda e çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku analizimi i një molekule të acidit nukleik përfshin zbatimin në të paktën një pjesë të molekulave të acidit nukleik e të paktën të një teknike të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga vijimësia paralele në mënyrë masive, mikrorradhë, hibridizimi, PCR në kohë reale, PCR digjitale dhe spektrometrinë masive.
6. Metoda e çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku shpërndarja statistikore përfshin një shpërndarje Poisson.
7. Metoda e pretendimit 6, që përfshin edhe :

pasurimin e mostrës biologjike të përfshirë nga femra shtatzënë për molekula të acidit nukleik në një zonë të targetuar; dhe
vijimësinë e shumicës së molekulave të acidit nukleik nga mostra e pasuruar biologjike, vijimësi e cila është specifike për zonën e targetuar ,

ku identifikimi i vendosjes së molekulës së acidit nukleik në genom human përfshin përdorimin e rezultateve të renditjes për të identifikuar vendosjen e molekulës së acidit nukleik në zonën e targetuar të genomit human.

8. Metoda e pretendimit 7, ku pasurimi i mostrës biologjike përfshin renditjen me anë të kapjes së fazës së zgjidhjes, kapjes mikrorradhë, ose amplifikimit të targetuar.
9. Metoda e pretendimit 7 ose 8, ku babai ka një genom paternal, ku përcaktimi i një ose më shumë vendndodhjeve të para përfshin:
përcaktimin se genomi paternal është homozig për allelen e parë respektive në çdo vendosje të vendndodhjeve të para dhe përcaktimin se genomi maternal është homozig për allelen e dytë respektive në të njëjtën vendndodhje.
10. Një program kompjuteri që përfshin kodin software të aftë për ekzekutim me anë të një procesori të sistemit kompjuterik, program kompjuteri ky i cili është i konfiguruar të kryejë në zbatim, një metodë sipas çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme.

TRANSFERIMI I PRONËSISË

(11) 8054

(21) AL/P/ 2018/889

(54) PERBERJE FARMACEUTIKE QE PERMBAJNE NJE PERZJERJE PROENZIME DHE ENZIME

(97) EP3071218 / 31/10/2018

(73) Trnka, Frantisek and GenuStar s.r.o.

Cechova 42, 370 01 Ceske Budejovice, CZ ;Stříbrná náves 707/16, Třebeš, 500 11 Hradec Králové, CZ

(74) Vladimir Nika

Bul. Gj.Fishta Pall.1 Jeshil prane Shallvareve, Kati 6, Ap. 16, Tirane

(11) 8606

(21) AL/P/ 2019/305

(54) FORMULIM RNA PER IMUNOTERAPI

(97) EP2830593 / 27/02/2019

(73) TRON - Translationale Onkologie an der Universitätsmedizin der Johannes Gutenberg- Universität Mainz gemeinnützige GmbH and BioNTech SE

Freiligrathstrasse 12, 55131 Mainz, DE ;An der Goldgrube 12, 55131 Mainz, DE

(74) Aleksandra Meçaj

Rr.Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, Shk.5,Ap70/4 Tiranë, 100

(11) 8384

(21) AL/P/ 2019/501

(54) DERIVATI I AZOL BENZENES

(97) EP2952513 / 10/07/2019

(73) TEIJIN LIMITED

2-4, Nakanoshima 3-chome, Kita-ku, Osaka-shi , Osaka 530-0005 , JP

(74) Arben Kryeziu

Rr. Idriz DOLLAKU, Pall.5, Shk.2, Ap.39, Tirane, Kutia Postare 8198

(11) 9894

(21) AL/P/ 2021/41

(54) NJË PROCËS PËR PËRGATITJEN E NJË FORME TË DOZËS ORALE ME NJËSI TË SHUMËFISHTË TË ÇLIRIMIT TË MODIFIKUAR TË DOKSILAMINE SUKSINAT DHE PIRIDOKSINË HIDROKLORID

(97) EP3628311 / 11/11/2020

(73) ITALFARMACO S.P.A.

Viale Fulvio Testi, 330, I-20126 Milano (MI), IT

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(11) 10589

(21) AL/P/ 2021/800

(54) Antitrupat bispecifik anti-VEGF/anti-ANG dhe përdorimi i tyre në trajtimin e sëmundjeve vaskulare të syrit

(97) EP3495387 / 01/09/2021

(73) F. Hoffmann-La Roche AG

Grenzacherstrasse 124, CH-4070 Basel, CH

(74) Eno DODBIBA

RR."Naim FRASHERI" P.60/3, Shk.1, Ap.16, Tiranë

NDRYSHIMI I EMRIT TË PRONARIT/APLIKANTIT

(11) 11336

(21) AL/P/ 2022/547

(54) PRODUKT I KUJDESIT ORAL

(97) EP3930663 / 07/09/2022

(73) CURASEPT A.D.S. S.P.A.

Via Parini 19/A, 21047 Saronno, IT

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

APLIKIME KOMBËTARE PËR PATENTË

(22) 28/10/2020

(21) AL/P/ 2020/731

(54) MODELIMI MEKANIK I SONDËS ME SENSOR TË SHKALLËZUAR PËR MATJEN E VIZKOZITETIT TË BIOMASËS DHE MODELIMI MEKANIK LASERIK I MBUSHJES SË AMBALAZHIT NË REPARTIN E PAKETIMIT TË PRODUKTIT INDUSTRIAL

(30)

(71) VALDRIN BELULI

ARBËRIA, BAJRAM LLOVCA 3/32, GJILAN, KOSOVË, KS

(72) VALDRIN BELULI (ARBËRIA, BAJRAM LLOVCA 3/32, GJILAN, KOSOVË)

(55)

(57)

Abstrakti

Modernizimi i teknologjisë së prodhimit konvertohet në një produkt sa më cilësorë të jetë e mundur dhe çdo industri si pikë synim kryesorë ka prodhimin e një produkti pa defekte fizike, kimike e atë biologjike dhe këto defekte mënjanohe duke rritur shkallen e inovacionit në automatizëm dhe në marrjen e rezultateve sa më të sakta të jetë e mundur për ti eliminuar gabimet inxhinierike në prodhim. Ne studimin tonë kemi modeluar në aspektin mekanik dy pika mjaftë të rëndësishme për prodhimin e një biomase dhe këto pika janë: matja e viskozitetit dhe nivelimi i mbushjes së paketimit me biomasë përmes laserit 650 nm.

Viskoziteti si fenomen studiohet mjaftë shumë në industri ushqimore dhe në atë kimike. Në rastin tonë ne kemi projektuar në aspektin mekanik një sondë me sensor të shkallëzuar për marrjen e rezultateve të shkallës së viskozitetit të biomasës në industri. Një nga pika më të rëndësishme të një industrie është paketimi i një produkti dhe shpesh nëpër industri shfaqen probleme serioze mekanike në mbushjen e ambalazhit me produkt. Ky lloj studim mekanik te reparti i ambalazhimit është vendosur në fokus sensorët, laser 650 nm dhe detektorë. Laserët dhe sensorët që ne kemi projektuar në aspektin mekanik do të na mundësojnë të ndërtojmë një automatizëm që mundëson eliminimin e shumë problemeve mekanike dhe deformim të produktit të prodhuar. Këto pika kritike që ne kemi vendosur në proces për automatizim nuk mundin të ndodhin gabimet elementare në shkatërrimin e cilësisë së një produkti, pra ky studim i jonë nuk i lejojnë teknologun apo inxhinierin që procesi dhe ambalazhi të devijojë. Pikat kritike maksimale dhe minimale do të monitorohen gjatë gjithë kohës, nëse rangu i vijës kapërcen minimumin dhe maksimumin, atëherë sistemi e lajmëron operatorin që në këtë pjesë të procesit produkti nuk është duke u prodhuar sipas standardit që ne jemi duke kërkuar, pra ky sistem është shumë i vlefshëm për çdo industri që të mos lejohen gabimet e mëdha në prodhim apo dëmtimeve ekonomike të industrisë.

Fjalët kyqe: *Modernizimi i pikave teknologjike, modelimi mekanik, biomasë, viskozitet, paketim qelqi, sensor, sonda, rrezatim laser, detektori.*

1. Hyrja

Inxhinieria ushqimore posedon një rolë shumë të rëndësishëm në mbajtjen e një jetë të qëndrueshme në shndërrimin e lëndës së parë në një produkt të caktuar dhe falë teknologjisë së avancuar sot në prodhojmë produkte të ndryshme që na mundësojnë të tregtojmë dhe të avancohemi në krijimin e produkteve të reja inovative që të kenë vend brenda shportës sonë familjare të përditshme. Teknologjia ushqimore në studim të parë ka rolë vendimtarë në cilësinë e një produkti që në dëshirojmë të prodhojmë, sa më e avancuar të jetë teknologjia e përdorur në një

industri rrit cilësinë e produktit ushqimorë. Automatizimi i teknologjisë ushqimore dhe asaj kimike është një hap shumë i rëndësishëm për të gjithë e veçanërisht për kontrollin e cilësisë së ushqimit sepse i eliminon gabimet që mund të jenë brenda një procesi. Rregullatorët më të përdorur janë ato elektrike dhe duke i përfshirë ato pneumatike. Rregullatorët elektrik kanë më shumë avantazh sepse sinjali elektrik transmetohet me lehtësi dhe pa vonësë dhe nuk shkakton avari në proces. Aparaturat matëse të kontrollit janë të larmishme dhe përdoren gjerësisht në shkallë industriale. Aparaturat matëse që do të përdoret në kontrollin automatik të proceseve është specifike dhe përmbushë standardin themelor të përdorimit lidhur me transmetimin dhe transformimin e sinjalit, me qëllim që ky të jetë i përshtatshëm për rregullatorin, intervalin matës të biomases, saktësinë, gabimet etj. Në shumë industri ne kemi hasur në shumë gabime ku referohen në temperaturën e materialit se a është zierë masa si duhet në një interval kohorë sipas standardit të prodhimit që përgatitet brenda një biorekatori. Në studimin tonë shkencorë temperatura si pikë referuese nuk mund të shmanget, por ajo që duhet të jetë prezent patjetër është sensori me sondë shtytëse (presion i ushtruar në kokën e pistonit) për matjen e viskozitetit të materialit (biomases). Studimi jonë shkencorë ka pasuar për qëllim të rregulloj një sensor me sondë për matjen e viskozitetin e lëndës rrjedhëse në një tub pas zierjes së një produkti me karakter ushqimorë dhe në këtë rast funksioni i transmetimit përcaktohet në rrugën e procesit duke futur masën në hyrje të procesit dhe duke lexuar më pas rezultatet në dalje të tij, shiko formën e përgjithshme të modelimit mekanik në Figurën 1 (A). Gjithashtu ne kemi studiuar edhe nivelin matës të mbushjes së ambalazhit me produkt. Në këtë studim kemi përdorur laser që përcakton nivelin deri ku duhet të mbushet paketimi i llojit qelq. Laserët janë duke gjetur zbatim të fuqishëm në shkencën e mekatronikës veçanërisht në teknologjinë ushqimore në shumë departamente. Shpesh makineritë e mbushjes që janë me piston bllokohet nga papastërtitë dhe nga ky problem shfaqen defekte bllokimi në piston të brendshëm të tubit mbushës në repartin e paketimit dhe për të eliminuar këtë problem ka qenë e domosdoshëm modelimi i një sistemi të ri për mbushjen e paketimit me përmbajtje qelqi me produkt, shiko formën e përgjithshme të modelimit mekanik në Figurën 1 (B).




Fig. 1. (A) Forma e përgjithshme e modelimit mekanik të sondës me shtytje për matjen e viskozitetit nga sensor i shkallëzuar dhe (B) forma e përgjithshme e modelimit mekanik të sensorëve dhe laserëve nivelizues për paketimin e biomases

Problemi është

2. Objektivat e studimit për sensorin në matjen e viskozitetit të biomasës

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi është të modelojmë një sensor në formë sonde për matjen e viskozitetit të biomasës me karakter ushqimorë që rrjedhë në një tub. Ky hulumtim ka këto objektiva specifike:

1. Për të modeluar dhe ndërtuar një sensor elektronik në formë pistoni (sondë) për matjen e viskozitetit të biomasës pas zierjes.
2. Për të modeluar vendosjen e sensorit pneumatik elektronik në tubin ku rrjedh biomasa
3. Për të përcaktuar mënyrën e pranimi të përgjigjes së sensorit pneumatik elektronik për biomasën rrjedhës të bazuar në shkallën e viskozitetit të materialit.
4. Për të vërtetuar se sa e rëndësishëm është ky lloj sensori për teknologjinë ushqimore dhe për të eliminuar gabimet që mund të shfaqen në zierjen e biomasës

2.1. Sonda me shtypje për matjen e viskozitetit të biomasës

Sensori për matjen e viskozitetit të biomasës është e përberë nga: Muri kryesor, sensori i shkallëzuar, pistoni cilindrik, kanali i vjaskuar, pistoni trapezoid, goma me shtypje të butë, butona elastik, shiriti rrëshqitës dhe unaza rrëshqitëse në shiritin e vajosur. Vaji që përdoret nuk duhet të përmbaj nga rrëshirat e naftës por duhet të jetë vajë organik pa efekte anësore në shëndetin e njeriut.

2.2. Përmasat e sondës me shtypje për matjen e viskozitetit të biomasës

- a. *Muri kryesor*: gjatësia (20 cm) dhe gjerësia (5.4 cm),
- b. *Muri i brendshëm i sondës së vjaskuar*: gjatësia (20 cm) dhe gjerësia (3 cm),
- c. *Pistoni cilindrik*: gjatësia (3 cm), diametri (2.99 cm),
- d. *Pistoni trapezoid*: koka e trapezoidit (2 cm), diagonalja e brinjës (3 cm), baza (2.99 cm), shiriti rrëshqitës (0.2 cm), diametri i unazës rrëshqitëse (0.22 cm),
- e. *Rruga e përshkruar nga pistoni cilindrik dhe trapezoid*: pistoni cilindrik përshkon rrugë deri në gjatësi (15 cm), baza e mbështetjes së pistoni trapezoid është në gjatësinë e rrugës (15 cm), hapësira e ushtrimit të presionit në gomave elastike të sensorit është (2 cm),
- f. *Sensori i shkallëzuar*: gjatësia e kutisë së sensorit (2.5 cm), gjerësia e kutisë së sensorit (2 cm), gjatësia e gomave me shtypje të butë me shkallëzim në sensor (2.5 cm, 2 cm, 1.5 cm, 1 cm), diametri i gomës elastike (0.03 cm), distanca e gomave në sensor (0.02 cm)

2.3. Përshkrimi i funksionimit të sondës me shtypje dhe përdorimi i sensorit të shkallëzuar

Rrjedhja e biomasës nëpër tub varet nga kapaciteti i prodhimit prandaj ne nuk mundemi të përcaktojmë përmasat e tubit me biomasë, por saj përket sensorit me sondë shtytëse të gjitha pajisjet janë projektuar me detaje siç i kemi përshkruar më lart dimensionet. Kjo lloj sonde

vendoset në tub ku rrjedhë biomasa për matjen e viskozitetet dhe në cep të tubit dhe sondës vendoset një thyerje të rrjedhjes (metal i hollë) që të futet biomasë sa më lehtë të jetë e mundur në sondën shtytëse me sensor të shkallëzuar, shiko Figurën 2.

Funksionimi i sondës është mjaftë i komplikuar prandaj kemi qenë të detyruar që të detajojmë në çdo pikë ashtu siç duhet që të mos ketë gabime gjatë implementimit në industri prodhimi. Biomasa shkakton presion në sondën cilindrike në një tub në formë vjaske dhe pas kësaj ushtrohet presioni i dytë në sondën trapez, kjo sondë do shtyp gomat që ushtrojnë forcë te butonat e sensorit për të marrë rezultatin inxhinierët rreth shkallës së viskozitetit të biomasës, shiko Figurën 2.




Fig. 2. Modemimi mekanik i sondës për matjen e viskozitetit të biomasës me sensor

3. Objektivat e studimit për matjen e nivelit të mbushjes së ambalazhit me produkt përmes laserit

Qëllimi kryesor i këtij projektimit është që industrinë të përdorin teknologji të avancuar, të modernizojmë repartin e paketimit në aspektin mekanik dhe që sinjalet të përkthen në grafike lehtë të kuptueshëm që inxhinieret të kenë përgjigjeje sa më të shpejtë dhe vendime sa më të sakta. Me kalimin e kohës shumë industri posedojnë problem me tubat që realizojnë mbushjen e paketimit (në rastin tonë kavanoz qelqi) sepse nga përdorimi i madh i tyre fillojnë të bllokohen pistonat nga papastërtitë dhe nga bllokimi i pistonit për të ndërprerë rrjedhjen e biomasës shkakton avari të lartë në makinerinë e mbushjes së paketimit.

Ky hulumtim ka këto objektiva specifike:

1. Modernizimi i teknologjisë së paketimit me ndihmën e laserëve 650 nm,
2. Projektimi i pllakës lëvizëse me sensor për bllokimin e rrjedhjes së biomasës pas mbushjes së paketimit,
3. Eliminimi i pistonave të mbushjes që mund të përmbajnë papastëritë dhe të bllokohen,
4. Projektimi i lidhjes së rrjetit kryesorë të paketimit me ndihmën e laserit duke filluar nga rrjedhja e biomasës dhe shiritit transportues të paketimit

3.1. Përmasat për sistemin teknologjik të mbushjes së ambalazhit me produkt përmes laserit

Duhet të veçohet se në këtë pikë të projektimit teknologjik nuk mundemi të ofrojmë përmasat e pajisjeve sepse kjo varet nga kapaciteti prodhues ditore i një industrie dhe e kjo mundëson të jetë e vështirë të jepen për çdo detal përmasat e gypave, shpejtësia e shiritit transportues, distanca e vendosjes së laserit diametri i tubit që rrjedhë biomasa, madhësia e ambalazhit etj. Pothuajse asnjë industri nuk zotëron të njëjtin kapacitet të prodhimit, prandaj ne nuk kemi dhënë përmasat milimetrike dhe këto përmasa jepen vetëm nëse dihet kapaciteti i përgjithshëm industrial i prodhimit dhe paketimit në sektorin e ambalazhit.

3.2. Përshkrimi i funksionit laserik (650 nm) në paketimin e biomasës në repartin industrial të paketimit

Pika e dytë e studimit tonë është mbushja e ambalazhit me produkt të kontrolluar nivelin me laser. Kohët e fundit po përdoren mjaftë shumë fusha e Fizikës laserike për ti eliminuar disa gabime që ndodhin vazhdimisht në industri dhe në rastin tonë Fizika laserike ka gjetur një zbatim të fuqishëm për të eliminuar një automatizëm shumë të komplikuar të mbushjes së paketimit (ambalazhit) me biomasë çka do të thotë që kostoja sipas automatizimit tonë nuk është enorme dhe nuk zënë shumë vend për të implementuar në një industri.

Funksionimi është i bazuar nga laseri me gjatësi valore prej 650 nm që e godet paketimin prej qelqi dhe gjatë rrezatimit të paketimit me këtë gjatësi valore, një pjesë e rrezes së paketimit pa produkt

Duhet të jepen përmasat e gypave, shpejtësia e shiritit transportues, distanca e vendosjes së laserit diametri i tubit që rrjedhë biomasa, madhësia e ambalazhit etj.

kalon përtej qelqit dhe regjistrohet nga një detektor, shiko Figurën 3 . Me kalimin e kohës kur tubi fillon nga lartë të rrjedhë biomasën atëherë kavanoza prej qelqit fillon të mbushet me produkt biomase dhe rrezja e laserit fillon të mos depërtoj përtej paketimit dhe detektori në atë moment nuk regjistron përgjigje të rrezatimit atëherë detektori bashkëpunon me sensorin e vendosur në tubë që quhet sensori i pllakës, shiko Figurën 4. Sensori pllakës ka formën e një çekani me kokë të rumbullakët ku shtyp pllakën në mënyrë horizontale nga ana e majtë për të mbyllur tubin e rrjedhës së biomasës deri sa të arrijë ambalazhi tjetër me radhë. Pllaka lëvizëse arrin të mbyll rjedhjen e tubit ajo shkon deri në pikën maksimale të përputhjes së metalit ku shtyp një gomë pistoni deri në shtypjen e sensorit përfundimtarë të anës së djathtë siç shihet në Figurën 5. Gjithashtu ne kemi përshkruar në Figurën 6 rrjetin e përbashkët të funksionimit të mbushjes së ambalazhit me motorin e përgjithshme të shiritit transportues.




Fig. 3. Forma e përgjithshme e modelimit mekanik të sistemit të mbushjes së biomasës me nivelizues laserik




Fig. 3. Modelimi mekanik i detajuar i pllakës lëvizëse të sensorëve në tubin rrjedhës të biomasës në sektorin e paketimit




Fig. 5. Modelimi mekanik i rrjetit transportues të shiritave dhe rrezatimi laser me gjatësi valore 650 nm

4. Pretendimi

1. Sondë me shtypje nga materiali rrjedhës për matjen e viskozitetit të biomasës me sensor të shkallëzuar.
2. Si sondë e mundëson që shtypjen që krijohet nga rrjedhja të kthehet në sinjal të përkthyer nga sensori i shkallëzuar.
3. Sensori i shkallëzuar mundëson të regjistrojë vlerën e shkallës së viskozitetit të biomasës.
4. Kjo sondë eliminon gabimet inxhinierike në industrinë e prodhimit të një produkti.
5. Ndërtimi i një sistemi laserik me gjatësi valore 650 nm për përcaktimin e nivelit të mbushjes së paketimit.
6. Sensorët e vendosur në tubin rrjedhës për mbushjen e paketimit janë të lidhura me laserin.